



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1154/2 Prot.

Vlorë më, 15.082022

VENDIM

Nr. 21, datë 15.08.2022

PËR  
PAGESËN E MBINGARKESËS MËSIMORE TË REALIZUARA PËR STAFIN  
AKADEMIK, PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022

Në mbështetje të nenit 49 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 19, pika 1, gërma e të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë" si dhe referuar propozimit të Administratorit nr.635/27 prot, datë 29.07.2022 dhe Vendimit të Senatit Akademik të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë nr.29, datë 27.07.2022, në mbledhjen e datës 15.08.2022 Bordi i Administrimit

VENDOSI

1. Të miratojë pagesën e mbingarkesës mësimore për vitin akademik 2021-2022 deri në 200 orë ne auditor.
2. Referuar nenit 2, pika 1 të Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018 2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë" të miratojë pagesën e mbingarkesës mësimore për vitin akademik 2021-2022 nga 200-300 orë për orët suplementare në auditor, vetëm për rastet ku ekziston propozimi i njësisë bazë dhe miratimi i drejtuesit të njësisë kryesore, i cili e konsideron rastin si specifik.
3. Të miratojë pagesën për orët jashtë auditorit, referuar vendimit nr. 29, datë 27.07.2022 të SA si dhe shkresave të zv/Rektorit Akademik dhe Administratorit përveç pagesës së mbingarkesës të orëve të udhëheqjes së temave të diplomës.
4. Ngarkohen për zbatim të këtij vendimi Administratori dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Sotir NIKOLLA

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele  
Tel. Fax ++355222288

web-site: [www.univlora.edu.al](http://www.univlora.edu.al)  
e-mail: [info@univlora.edu.al](mailto:info@univlora.edu.al)

